VENDIM
Nr. 51, datë 3.5.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "HEC LANABREGAS" SHA

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", nenit 15 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1 germa "a" të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.5.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime, Tiranë, sh.a. për modifikim te licencës së prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë HEC Lanabregas sh.a., dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria "HEC-Lanabregas" sh.a. plotëson kërkesat e "Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa "a":

Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa "b":

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës së shoqërisë "HEC Lanabregas" sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani